



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 47 regjistër (JR)
Datë 19.11.2024

Nr. 94 i vendimit
Datë 16.12.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Rezarta Schuetz	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 16.12.2025, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 47/2024 (JR), datë 19.11.2024, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Xhevahir Lita, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 796, datë 04.09.2024, që i përket subjektit të rivlerësimit Xhevahir Lita.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet A - F të Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 62, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “c” e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kodi i Procedurave Administrative; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit Xhevahir Lita të paraqitura në ankim, i cili kërkoi prishjen e vendimit nr. 796, datë 04.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe kryerjen e një procesi të rregullt rivlerësimi nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në bazë të tri kriterëve të rivlerësimit, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ai i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Nga aktet e fashikullit të përcjellë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar brenda afatit ligjor¹, në përputhje me nenin 35, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën për kontrollin e figurës².
3. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016 dhe, më datë 02.11.2017, dërgoi një raport të arsyetuar pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me konstatimin për përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës. Ky raport, në vijim, është rishikuar nga grupi i punës dhe i është përcjellë Komisionit në datën 14.11.2023. Në këtë raport, të përcjellë nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, grupi i punës është shprehur: *Në vlerësim të të dhënave që disponohen nga autoritetet verifikuese për subjektin e rivlerësimit Xhevahir Lita, arsyetohet se integriteti profesional është përcaktues për pastërtinë e figurës së subjekteve të rivlerësimit.* Në përfundim, grupi i punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

¹ Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

² Dorëzuar pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, më datë 23.01.2017.

4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, AKSIK-u dhe KLP-ja³, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin Xhevahir Lita bazuar vetëm në kriterin e kontrollit të figurës, duke marrë vendimin nr. 796, datë 04.09.2024.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 796, datë 04.09.2024, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Xhevahir Lita, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës [...]”.
6. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzionit përfundimtar si vijon.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe pasi mori në shqyrtim pretendimet e përfaqësuesit të subjektit të rivlerësimit, konstatoi se në zbatim të nenit 61, “Shkarkimi nga detyra”, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, nga vlerësimi tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

III. Shkaqet e ankimit

7. Subjekti i rivlerësimit iu drejtua Kolegjit të Posaçëm të Apelimit me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 796, datë 04.09.2024, me pretendimin se ky është një vendim i padrejtë, i pabazuar në ligj dhe në prova, si dhe i marrë në shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, të përcaktuara në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim referuar “KEDNj”).
8. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenet 42 dhe 179/b, pikat 2 dhe 5 të Kushtetutës, në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 6 të KEDNj-së, në nenet 4, pikat 1 dhe 2, 5, 45 dhe 66, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 44 të Kodit të Procedurave Administrative, kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
 - *Prishjen e vendimit nr. 796, datë 04.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*
 - *Kryerjen e një procesi të rregullt rivlerësimi nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në bazë të tri kritereve të rivlerësimit.*
9. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale të procesit dhe çështjet e zbatimit të legjislacionit parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

³ *Shih paragrafët 4 e 6 në faqen 2 të vendimit të Komisionit nr. 796, datë 04.09.2024.*

9.1. *Procesi i rivlerësimit në Komision ka qenë një proces i parregullt ligjor në kuptim të neneve 42 e 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, neneve 4, pikat 5 dhe 6 dhe 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.*

10. Shkaqet e ankimit në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

10.1. *Përfundimet e arritura nga Komisioni në vendimin objekt ankimi, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar dhe se me sjelljen dhe veprimet e tij ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, janë bazuar tërësisht në fakte dhe rrethana që i referohen procedimit penal dhe janë pjesë e hetimit penal të kryer ndaj subjektit të rivlerësimit, duke cenuar një ndër elementet përcaktuese të së drejtës për proces të rregullt ligjor, siç është ai i prezumimit të pafajësisë.*

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. *Mbi aspektet procedurale të gjykimit*

a) *Juridiksioni i Kolegjit*

11. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit Xhevahir Lita, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

12. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁴ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

⁴ Siç rezulton nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 796, datë 04.09.2024, për rivlerësimin e subjektit Xhevahir Lita, i është njoftuar avokatit të tij, z. A. N., sipas prokurës së posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.10.2024, me shkresën nr. {***} prot., datë 29.10.2024, konfirmuar marrja dijani sipas lajmërimarrjes më datë 31.10.2024, kurse ankimi i subjektit të rivlerësimit, i nënshkruar prej këtij të fundit dhe avokatit, është depozituar pranë Komisionit më datë 12.11.2024, protokolluar në Komision me nr. {***}, datë 12.11.2024, që rezulton të jetë dita e 13-të e afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

13. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 796, datë 04.09.2024, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
14. Në përfundim, trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të çështjes, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, nuk konstatoi shkelje procedurale të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Mbi pretendimet e ankuesit në parashtrimin e shkaqeve të ankimit

Vlerësimi i shkaqeve që lidhen me aspekte procedurale të procesit dhe çështje të zbatimit të legjislacionit

15. *Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në kuptim të neneve 42 e 179/b, pika 2 e Kushtetutës, të nenit 6 të KEDNj-së, të neneve 4, pikat 5 dhe 6 dhe 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit ngriti pretendimet se:*

15.1. *Është gjykuar nga një gjykatë e njëanshme dhe paragjyqese, pasi sipas tij hetimi kryesisht në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit po nga i njëjti trup gjykues i Komisionit, cenon haptazi parimin e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se shfaqje e veprimit paragjyqes nga ana e trupit gjykues, është edhe fakti që Komisioni ka filluar hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të kontrollit të figurës, duke mos vendosur për dy kriteret e tjera, atë të vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimit të aftësive profesionale. Sipas subjektit të rivlerësimit, fakti që ai nuk është vënë në dijeni lidhur me raportet e përgatitura nga ILDKPKI-ja dhe KLP-ja mbi vlerësimin përkatësisht të pasurisë dhe aftësive profesionale, dhe se këto raporte nuk rezultojnë të jenë debatuar as në seancën dëgjimore në Komision, merren të mirëqena, sipas tij, që ato plotësojnë kushtet ligjore për konfirmimin e tij në detyrë. Sa më sipër, sipas subjektit të rivlerësimit, mbështet pretendimin e tij se trupa gjyqese ka vepruar me doza të larta paragjykimi që kanë ndikuar në humbjen e ekuilibrit përgjatë procesit të rivlerësimit të tij.*

15.2. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, ka shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë në kuptim të nenit 30 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, pika 2 e KEDNj-së, pasi përfundimet e arritura nga Komisioni janë pjesë e hetimit penal ndaj subjektit të rivlerësimit.

15.3. Sipas subjektit të rivlerësimit, raporti i përditësuar i AKSIK-ut vjen në kundërshtim të hapur me dispozitat ligjore në fuqi, konkretisht Aneksin e Kushtetutës, ligjin nr. 84/2016, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se raporti i AKSIK-ut u referohet të dhënave që i përkasin periudhës kohore 2020-2021, periudhë e cila, sipas tij, nuk i përmbahet periudhës së vlerësimit të përcaktuar shprehimisht në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon: *Subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklaramit, sipas ligjit.* Si rrjedhojë e sa më sipër, subjekti pretendoi se rishikimi apo përditësimi i raportit është bërë pa bazë ligjore dhe tej afateve të përcaktuara në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit *DSIK-ja ,brenda 60 ditëve, duhet të verifikojë dhe të hartojë raportin për subjektin e rivlerësimit dhe, në vijim, brenda 10 ditëve duhet ta përcjellë këtë raport pranë Komisionit.* Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se raporti i dytë i AKSIK-ut, i cili është bazuar në të dhënat e administruara nga SPAK-u, është i pambështetur në prova dhe në ligj dhe ndryshimi i tij ka ardhur si rezultat i procedimit penal të regjistruar nga SPAK-u në ngarkim të tij.

16. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi verifikoi procedurat e ndjekura në Komision lidhur me zhvillimin e procesit të rivlerësimit të subjektit Xhevahir Lita, si dhe aktet e administruara në fashikullin e çështjes, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.

16.1. Me vendimin nr. {***}, datë 22.12.2020, Komisioni ka vendosur fillimin e hetimit administrativ mbi procedurën e rivlerësimit nga relatori. Referuar përmbajtjes së këtij vendimi, nuk vihet re që Komisioni të ketë bërë përcaktime që orientojnë procedurën e rivlerësimit kalimtar drejt fillimit të hetimit vetëm për njërin nga tri kriteret e rivlerësimit, sikundër pretendoi subjekti i rivlerësimit në ankim.

16.2. Me vendimin nr. {***}, datë 30.5.2024, Komisioni ka vendosur të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Xhevahir Lita, bazuar në rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, të paraqitur nga relatori i çështjes. Në njoftimin e dërguar subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit shprehet se: *[...] ka përfunduar hetimin administrativ të zhvilluar kryesisht për 1 (një) nga 3 (tri) kriteret e rivlerësimit dhe ju fton [...].*

16.3. Subjekti i rivlerësimit, i përfaqësuar nga avokati i tij A. N., më datë 10.07.2024, së bashku me shpjegimet ndaj rezultateve të hetimit, ka dorëzuar pranë Komisionit edhe një kërkesë me objekt: “Kërkoj çeljen e hetimit administrativ edhe për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale”. Referuar përmbajtjes së kësaj kërkesë, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur para Komisionit kundërshtimin e tij lidhur me vendimin e Komisionit për mbylljen e hetimit administrativ bazuar vetëm në vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës, duke paraqitur të njëjtat argumente si parashtruar para Kolegjit në shkakun e ankimit objekt shqyrtimi.

16.4. Trupi gjykues vëren se Komisioni, pasi ka shqyrtuar këtë kërkesë të subjektit të rivlerësimit, me vendimin nr. {***}, datë 15.07.2024, ka vendosur *refuzimin e kërkesës së përfaqësuesit të subjektit të rivlerësimit për çeljen e hetimit administrativ për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Xhevahir Lita*. Në vendimin e sipërcituar për refuzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për çeljen e hetimit dhe vlerësimin edhe të dy kritereve të tjera, të vlerësimit të pasurisë dhe aftësive profesionale, Komisioni është shprehur: *[...] trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën në tërësi, në lidhje me përfshirjen e dy komponentëve të tjerë të rivlerësimit, atij profesional dhe atij të figurës, sipas standardit të KPK-së dhe qëndrimin të konsoliduar tashmë të KPA-së, Komisioni mund të përfundojë hetimin administrativ bazuar vetëm në një nga kriteret. Në bazë të fakteve dhe provave deri në këtë moment, është arritur në nivelin e provueshmërisë në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.*

17. Në analizë të sa më sipër, nga shqyrtimi i procedurave të kryera në Komision, nuk u konstatua që Komisioni në vitin 2020 të kishte nisur hetimin administrativ vetëm për njërin prej tri kritereve të rivlerësimit, atë të kontrollit të figurës, duke shfaqur në këtë mënyrë paragjykim dhe, rrjedhimisht, pretendimi i subjektit në këtë drejtim, në vlerësim të trupit gjykues, mbeti në nivel deklarativ. Sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit, se vendimmarrja e Komisionit mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit vetëm për një kriter dhe refuzimi i kërkesës për riçelje të hetimit dhe rivlerësimit edhe të dy kritereve të tjera, përbën vendimmarrje të paragjykuar, në shkelje flagrante të ligjit dhe në cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim i subjektit, referuar jurisprudencës tashmë të konsoliduar të Kolegjit⁵, është i pabazuar në ligj. Kjo vendimmarrje e Kolegjit, referuar jurisprudencës së cituar, është bazuar në parashikimin e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit Komisioni merr vendim bazuar në një ose disa prej kritereve të rivlerësimit. Kjo dispozitë ligjore, e vlerësuar në harmoni me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit Komisioni u kalon barrën e provës subjekteve të rivlerësimit në momentin që ai arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, bën që vendimmarrja e Komisionit në këto raste, bazuar mbi parashikimet e mësipërme ligjore, të mos jetë as paragjyquese dhe as e paracaktuar. Mosbërja me dije subjektit të rivlerësimit e raporteve të organeve ndihmëse lidhur me verifikimin e pasurisë dhe vlerësimin e aftësive të tij profesionale, si dhe mosdebatimi i tyre në seancën dëgjimore, nuk është në asnjë rast tregues mbi rezultatin e këtyre raporteve dhe përmbajtjen e tyre, por lidhet vetëm me faktin që për kriteret e rivlerësimit për të cilat këto raporte janë përpiluar nga organet ndihmëse dhe administruar nga Komisioni, hetimi i plotë dhe i gjithanshëm i këtij të fundit lidhur me to nuk kishte përfunduar. Në këto kushte, pretendimet e subjektit për veprime të Komisionit me doza të larta paragjyquese, si pasojë e sa më sipër, vlerësohen të pabazuara në fakte.

18. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit për cenimin e procesit të rregullt ligjor në kuptim të cenimit të standardit të gjykimit të çështjes nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, si pasojë e mbivendosjes në të njëjtin trup gjykues të funksioneve të kryerjes së hetimit administrativ në

⁵ Shih vendimet e Kolegjit: nr. 7/2020 (JR), nr. 14/2021 (JR), nr. 34/2021 (JR), nr. 33/2022 (JR), nr. 40/2022 (JR) etj.

lidhje me kriteret e rivlerësimit, çmuarjes së provave dhe më pas marrjes së vendimit lidhur me rivlerësimin kalimtar, trupi gjykues e vlerësoi këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit të pabazuar në ligj. Ky vlerësim i materializuar tashmë në vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit dhe pjesë e jurisprudencës së konsoliduar të këtij të fundit, bazohet në arsyetimin se veprimtaria e trupës gjyquese të Komisionit, kompetencat në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë, në Aneksin e saj, si dhe në ligjin nr. 84/2016, kontrolli i kushtetutshmërisë së të cilit është vlerësuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 18.01.2017.

19. Në lidhje me pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të vlerësimit të ligjshmërisë së raportit të përditësuar të AKSIK-ut, trupi gjykues, pasi kreu verifikimet e nevojshme mbi hetimin e kryer nga ana e Komisionit lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, si dhe shqyrtoi korrespondencat e këtij të fundit me institucionet pjesë e grupit të punës⁶ për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit (të administruara sipas rregullave në fuqi për administrimin e dokumentacionit që përbën “sekret shtetëror”), vlerësoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për përditësimin e raportit të DSIK-së⁷, në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi, janë të pabazuara. Trupi gjykues konstatoi se raporti fillestar i përcjellë nga DSIK-ja me nr. {***} prot., datë 02.11.2017, me rekomandimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Xhevahir Lita, është përcjellë me shënimin: *Sqarojmë se ky raport është përpiluar pa përgjigjen e një prej 3 autoriteteve verifikuese, konkretisht Shërbimit Informativ të Shtetit.*
20. Në vijim, rezultoi të jetë përcjellë më datë 19.02.2018, pranë Komisionit, edhe shkresa e Shërbimit Informativ të Shtetit me informacion mbi subjektin e rivlerësimit Xhevahir Lita në kuadër të kontrollit të figurës së tij, me të dhëna të periudhës 2006-2017, shkresë kjo e cila, ndër të tjera⁸, ka shërbyer si bazë për kërkesën e Komisionit lidhur me nevojën për përditësimin e raportit fillestar.
21. Në vijim të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues e gjeti konform kërkesave të nenit 36 të ligjit nr. 84/2016, kërkesën e Komisionit nr. {***} prot., datë 18.10.2023, për përditësimin e raportit fillestar të përcjellë nga DSIK-ja me nr. {***} prot., datë 02.11.2017, duke mundësuar në këtë mënyrë përfshirjen e informacionit të përcjellë nga Shërbimi Informativ i Shtetit, pa të cilin raporti mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit nuk do të vlerësohej në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.
22. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se raporti i AKSIK-ut u referohet të dhënave që i përkasin periudhës kohore 2020-2021, periudhë e cila, sipas tij, nuk i përmbahet periudhës së vlerësimit të përcaktuar shprehimisht në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues konstatoi fillimisht se ky pretendim nuk bazohet në fakte pasi, nga verifikimi i kryer, rezultoi që

⁶ Sipas parashikimeve të nenit 36, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

⁷ Aktualisht AKSIK-u.

⁸ Janë përcjellë gjithashtu: një tjetër shkresë e të njëjtit institucion (ShISh) më datë 08.07.2022, me të dhëna të periudhës kohore 2018-2021, shkresa e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore e datës 30.08.2023, si dhe shkresat e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të datës 11.08.2023 dhe të datës 05.02.2024.

të dhënat e përcjella nga institucionet verifikuese, i përkisnin intervalit kohor nga viti 2006 deri në vitin 2021 dhe jo vetëm periudhës kohore të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit 2020-2021.

23. Në çdo rast, në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kontrolli i figurës bëhet sipas parimeve dhe afateve të përcaktuara në mënyrë të shprehur në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, i cili është, sipas subjektit të rivlerësimit, nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklarimit, trupi gjykues gjen me vend të ritheksojë se pretendime të tilla janë vlerësuar nga Kolegji të pabazuara në ligj.
24. Kolegji rikonfirmon qëndrimin e tij në vendimmarrje të mëparshme⁹ se, në referim të dispozitave kushtetuese dhe atyre ligjore në zbatim të të cilave zhvillohet procesi i rivlerësimit, konkretisht nenit Ç, pika 1 dhe nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, si dhe Kreut V të ligjit nr. 84/2016, kriteri kohor i përcaktuar në mënyrë të shprehur në pikën 2 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, i referohet vetëm detyrimit për plotësimin e deklaratës së detajuar për figurën dhe deklarimit në këtë kuadër, me saktësi dhe në përputhje me rubrikat përkatëse të saj, të çdo informacioni, të dhëne apo rrethane të ndodhur apo kërkuar brenda këtij afati kohor, për efekt të *vlerësimit të saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, një ndër elementet e përcaktuara në objektin e kontrollit të figurës sipas nenit 34 të ligjit nr. 84/2016, dhe jo ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme, element tjetër ky objekt i fushës së veprimtarisë së të njëjtit nen*. Ky element i kontrollit të figurës në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar (konstatimi i ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar), referuar të njëjtit kuadër kushtetues dhe ligjor, nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi të shprehur kohor. Elementi kohë në drejtim të këtij komponenti vlerësimi, ndikon vendimmarrjen e institucioneve të rivlerësimit vetëm në drejtim të vlerësimit të rrethanave lehtësuese, pa iu nënshtruar asnjë kufizimi tjetër, aq më pak një kriteri përjashtues si pretenduar nga subjekti i rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të pabazuar në ligj këtë shkak të ngritur në ankim nga subjekti i rivlerësimit.
25. Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë, në kuptim të nenit 30 të Kushtetutës dhe nenit 6, pika 2 e KEDNj-së, pasi përfundimet e arritura nga Komisioni, sipas subjektit, janë pjesë e hetimit penal të zhvilluar ndaj tij, trupi gjykues vëren se ky pretendim i ngritur në mbështetje të shkakut të ankimit për cenim të parimit të procesit të rregullt ligjor, i referohet fushës së të drejtës penale dhe proceseve me karakter penal. Ndërkohë që, referuar dispozitave të Aneksit të Kushtetutës, të cilat përcaktojnë rregullat dhe parimet e zhvillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ky proces ka natyrë mirëfilli administrative dhe jo penale. Për rrjedhojë, vlerësimi i gjetjeve nga hetimi administrativ, në kuadër të vendimmarrjes së organeve të rivlerësimit dhe tërë procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit, nuk u nënshtrohet standardeve të drejtësisë penale. Në këtë kontekst, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për shkelje të nenit 6, pika 2 e KEDNj-së, gjenden të pabazuara në ligj, sa kohë kjo dispozitë e KEDNj-së nuk është e zbatueshme në këtë proces me natyrë administrative.

⁹ Shih vendimin e Kolegjit nr. (JR) 7/2020.

Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

26. *Lidhur me shkaku e ankimit për kundërshtimin si të pabazuar nga subjekti i rivlerësimit të konkluzionit të Komisionit për vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.*
27. *Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit të subjektit Xhevahir Lita, ka arritur në konkluzionin se: [...] pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe pasi mori në shqyrtim pretendimet e përfaqësuesit të subjektit të rivlerësimit, konstatoi se në zbatim të nenit 61, “Shkarkimi nga detyra”, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Këtë konkluzion, Komisioni e ka arritur pasi ka arsyetuar se: [...] sjellja e subjektit të rivlerësimit bie ndesh edhe me mënyrën e sjelljes që pritet nga një magjistrat. Me këto veprime të konstatuara, duket se subjekti ka shkelur standardet e sjelljes së një magjistrati në veçanti, të cilat janë dhe duhet të jenë shumë më të larta se ato të shoqërisë në tërësi, duke treguar mungesë integriteti në zbatimin e ligjit, si dhe me sjelljen e tij personale ai ka ndikuar në të gjithë sistemin gjyqësor, duke qenë se sjellja e një magjistrati pritet të jetë një sjellje e paqortueshme, pavarësisht të gjitha rrethanave të paraqitura. Pavarësisht aktakuzave, ecurisë së procesit penal dhe përgjegjësisë penale të subjektit të rivlerësimit, që po ndiqen nga SPAK dhe gjykatat shqiptare, bazuar në faktet dhe provat e administruara në këtë proces administrativ, Komisioni konkludon se: Subjekti ka pasur kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Sjellja e subjektit të rivlerësimit Xhevahir Lita, me veprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.*
28. *Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të shkakut të ankimit për konkluzion të pabazuar lidhur me vlerësimin e këtij kriteri, pretendoi se përfundimet e arritura nga Komisioni në vendimin objekt ankimi, sipas të cilit: subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar dhe se sjellja e subjektit të rivlerësimit Xhevahir Lita, me veprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, janë bazuar tërësisht në fakte dhe rrethana që i referohen procedimit penal dhe janë pjesë e hetimit penal të kryer ndaj subjektit të rivlerësimit dhe se në rastin konkret cenojnë një ndër elementet përcaktuese të së drejtës për proces të rregullt ligjor, siç është ai i prezumimit të pafajësisë. Subjekti pretendoi se Komisioni ka vendosur shkarkimin e subjektit të rivlerësimit për një nga tri kriteret e rivlerësimit dhe konkretisht për kriterin e vlerësimit të figurës, bazuar në bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprat penale të parashikuara nga nenet 319/ç e 295/a/3 të Kodit Penal.*
29. *Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se respektimi i këtij parimi është i detyrueshëm si për organet e drejtësisë, edhe ato të administratës publike. Ky, sipas tij, është qëndrimi konsekuent i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por edhe i Gjykatës Kushtetuese, sipas së cilës: Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor*

të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza.

30. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues fillimisht konstatoi se pretendimet e paraqitura në mbështetje të këtij shkaku ankimi konstatohen të jenë ripërsëritje e pretendimeve dhe qëndrimit të subjektit të rivlerësimit ndaj rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit, për të cilat Komisioni, pas shqyrtimit të tyre, ka arritur në vendimin objekt ankimi. Trupi gjykues vëren gjithashtu se ndonëse Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të parashikimeve të nenit 3, pikat 6 dhe 15, vendimmarrja e tij për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar nuk rezulton të jetë bazuar në parashikimet e nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, por në parashikimin e pikës 5 të të njëjtit nen, duke i atribuar atij pasojën e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.
31. Në kuptim të sa më sipër, në një vlerësim formal, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka vendosur shkarkimin e tij për kriterin e kontrollit të figurës, bazuar në bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprat penale të parashikuara nga nenet 319/ç¹⁰ e 295/a/3¹¹ të Kodit Penal, është një pretendim i pabazuar në fakte.
32. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të çështjes, trupi gjykues konstatoi se nga hetimi administrativ¹², ka rezultuar se:

32.1 Bazuar në informacionin e dërguar nga SPAK-u me shkresën nr. {***} prot., datë 5.2.2024, ka rezultuar se nga agjencitë ligjzbatuese evropiane, është përcjellë informacion për disa shtetas shqiptarë, përdorues të platformës së komunikimit të enkriptuar *SkyECC*, të cilët dyshohen si të përfshirë në aktivitetet kriminal në fushën e krimeve kundër jetës, trafikimit të lëndëve narkotike të kryera në formën e grupit të strukturuar kriminal, falsifikimit të dokumenteve dhe shpërdorimit të detyrës e korrupsionit nga funksionarë publikë. Këta përdorues kanë koordinuar me njëri-tjetrin nëpërmjet komunikimeve të enkriptuara në aplikacionin *SkyECC*.

32.2 Në datën 18.7.2023, në regjistrin e njoftimit të veprave penale në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, është regjistruar emri si person nën hetim për subjektin e rivlerësimit dhe disa shtetas të tjerë P. Gj., B. B., B. M., E. H., A. B. etj. Nga hetimet paraprake të zhvilluara në kuadër të këtij procedimi, personi nën hetim Xhevahir Lita dyshohet të ketë qenë posedues dhe përdorues i aplikacionit *SkyECC*, me anë të të cilit ka mbajtur kontakte me përdorues të tjerë të këtij aplikacioni, të identifikuar si B. B., P. Gj. dhe B. M. Nga analizimi i bisedave të përdoruesit të aplikacionit *SkyECC*, i dyshuar si Xhevahir Lita, janë evidentuar të dhëna lidhur me dy episode, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur si vijon.

¹⁰ *Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë.*

¹¹ *Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete.*

¹² *Shih vendimin e Komisionit, paragrafët 26-29, në faqet 6-9.*

(i) Shtetasi B. B., në ngarkim të të cilit është regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër procedimi penal nr. {***}, datë 14.02.2020, për veprat penale “Vrasja me dashje, e mbetur në tentativë”, “Vrasja me dashje”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, “Organizimi i lotarive të palejuara”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, “Mashtrimi” në bashkëpunim, “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”, “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 76-25-22, 76-25, 278/2, 197, 287/a, 109/b, 143/2, 135 dhe 248 të Kodit Penal dhe që ndodhej në paraburgim, nëpërmjet aplikacionit *SkyECC@****** ka komunikuar me shtetasin P. Gj., i identifikuar si posedues dhe përdorues i *SkyECC@****** me qëllim interesimin për të dalë sa më shpejt nga paraburgimi, duke ofruar shuma parash në këmbim. Shtetasi P. Gj. ka kontaktuar me subjektin e rivlerësimit Xhevahir Lita, i cili rezultoi të ishte një nga dy prokurorët e ngarkuar për hetimin e çështjes, i identifikuar si posedues dhe përdorues i aplikacionit *SkyECC@****** duke u interesuar vazhdimisht dhe duke ofruar shuma parash në këmbim të zbutjes së masës së sigurimit të shtetasit B. B., të cilit në biseda me prokurorin Xhevahir Lita, i referohej me pseudonime, veprime këto të koordinuara me shtetasin B. B. Në datën 29.6.2020, me vendimin nr. 307 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, shtetasit B. B. i është ndryshuar masa e sigurimit nga “Arrest në burg” në “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. Pas kësaj date, më 30.6.2020, subjekti i rivlerësimit Xhevahir Lita ka kontaktuar drejtpërdrejt me shtetasin B. B., i identifikuar si posedues dhe përdorues i aplikacionit *SkyECC******.

(ii) Subjekti i rivlerësimit Xhevahir Lita, në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezultoi të ketë regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 21.2.2021, për veprat penale “Vrasja me paramendim”, mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga nenet 78-22-25 dhe 278/1 të Kodit Penal, pas referimit të oficerëve të policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, lidhur me episodin e ndodhur në të njëjtën datë në lagjen “{***}”, Bashkia Shkodër, ku tre persona në bashkëpunim kanë qëlluar me armë zjarri pistoletë ndaj shtetasve T. P. dhe K. M.. Pas fillimit të hetimeve paraprake, shtetasi B. M., i identifikuar si përdorues i aplikacionit *SkyECC@******, shtetasi E. H., i identifikuar si përdorues i aplikacionit *SkyECC@****** dhe shtetasi A. B., i identifikuar si përdorues i aplikacionit *SkyECC@****** (dy shtetasit e fundit të identifikuar nga policia gjyqësore si persona të dyshuar për ngjarjen në hetim) në bashkëpunim me njëri-tjetrin i kanë dhënë një shumë parash prokurorit Xhevahir Lita, i identifikuar si përdorues i aplikacionit *SkyECC@******, me qëllim devijimin e hetimeve dhe shmangien e ndjekjes penale për autorët. Shuma e parave është siguruar nga E. H. dhe B. M., i cili ka diskutuar paraprakisht me prokurorin Xhevahir Lita lidhur me shumën, e cila i është dorëzuar nga shtetasi A. B. në Tiranë. Subjekti i rivlerësimit i ngarkuar për hetimin e çështjes, pasi ka rënë dakord për shumën e parave, ka ndihmuar duke i dhënë informacione lidhur me veprimet hetimore që po kryhen, ka dhënë orientimet se si dhe çfarë duhet të deklarojnë në policinë gjyqësore, si dhe nuk ka kryer veprime të tjera që mund të çonin në identifikimin e autorëve, ka shmangur nga ndjekja penale shtetasit E. H. dhe A. B., duke akuzuar si autor të ngjarjes shtetasin

Sh. Xh., për të cilin ka lehtësuar akuzat penale, për të cilat është regjistruar procedimi penal duke e akuzuar për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit” dhe “Kanosja”, të parashikuara nga nenet 278/1 dhe 84 të Kodit Penal dhe, më pas, është dërguar për gjykim.

32.3 Këto episode dhe rrethanat në të cilat ato kanë ndodhur, të rezultuara nga hetimi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, bazuar në komunikimet e kryera në aplikacionin *SkyECC*, të poseduar dhe përdorur nga shtetasi Xhevahir Lita, i datëlindjes 08.03.1973 (subjekti i rivlerësimit), janë evidentuar në mënyrë të plotë në vendimmarrjet e GjKKO-së, konkretisht në vendimin nr. 94, datë 23.07.2023, me objekt “Caktim mase sigurie ndaj shtetasit Xhevahir Lita”, në vendimin penal nr. 97, datë 29.07.2023, me objekt “Ekzekutim mase sigurimi ndaj shtetasit Xhevahir Lita”, si dhe në vendimin e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me nr. 38, datë 31.08.2023, i cili ka lënë në fuqi vendimin e GjKKO-së nr. 94, datë 23.07.2023.

32.4 Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2238 (364), datë 22.12.2023, me të cilin ka lënë në fuqi vendimin nr. 38, datë 31.08.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar për të hetuarit P. Gj., E. P., A. H. dhe Xhevahir Lita, ka arritur në konkluzion mbi ligjshmërinë dhe përdorshmërinë e provave “mesazhe *chat*” në SKY ECC, të marra nga ekzekutimi i letërporosisë drejtuar autoriteteve gjyqësore franceze, pasi ka arsyetuar se: *[...] Kolegji konstaton se nga personat nën hetim P. B., E. P., A. H., dhe Xhevahir Lita pretendohet se vendimmarrja e gjykatave të posaçme është e pabazuar, duke pretenduar si shkak mungesën e “dyshimit të arsyeshëm” të bazuar në prova, kusht ky i parashikuar në nenin 228/1 të KPP. Kolegji konstaton se në thelb, ky pretendim argumentohet me mungesën e provave dhe papërdorshmërinë e tyre – mesazhet “chat” në SKY ECC – prova të siguruara deri në këtë fazë të hetimeve paraprake. Kolegji konstaton nga aktet e dosjes se të hetuarit e mësipërm kanë ngritur një sërë shkaqesh dhe pretendimesh lidhur me përdorshmërinë e provës mesazhe “chat” në SKY ECC, duke iu referuar në thelb mënyrës së marrjes së tyre (nga autoritetet e huaja dhe ato shqiptare), si dhe ligjshmërisë së kësaj prove. Në lidhje me pretendimet mbi mungesën e dyshimit të arsyeshëm, Kolegji konstaton se Gjykata e Posaçme e Apelit, referuar nenit 228/1 të KPK, ka arsyetuar në mënyrë të detajuar për secilin nga personat nën hetim [...] ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, duke treguar dhe analizuar provat mbi të cilat bazohet ky dyshim. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit është mjaftueshëm i arsyetuar dhe në respektim të standardit provues të kërkuar për këtë fazë të procedimit, të përcaktuar edhe në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 07/2011. Pretendimet e personave nën hetim P. B., E. P., A. H., dhe Xhevahir Lita për ligjshmërinë dhe përdorshmërinë e provës mesazhe “chat” në SKY ECC, kanë marrë përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Posaçme e Apelit, arsyetim të cilin ky Kolegj e gjen të drejtë dhe e mbështet në të gjitha argumentet e tij. [...] Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimet e mbrojtësve të të hetuarve Gj., P., H., dhe Lita për papërdorshmërinë e provave (për të gjitha shkaqet e përmendura në rekurs dhe memoriet me shkrim) dhe që pasjellin, sipas tyre, edhe mungesën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, janë pretendime të pabazuara dhe që kanë*

marrë përgjigje të argumentuar nga Gjykata e Posaçme e Apelit. Duke i konsideruar kështu të përdorshme provat e administruara deri në këtë moment të këtij procedimi penal [...].

33. Referuar parashikimeve kushtetuese, nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës – barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal, dhe nenit Dh, pika 3 e po të njëjtit Aneks – nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të provojë të kundërtën – trupi gjykues vërejtë se gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar në Komision dhe gjykimit të ankimit të tij në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk kishte kundërshtuar ekzistencën e komunikimeve me personat e përfshirë në krimin e organizuar, gjetje kjo e Komisionit për të cilën zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve të sipërcituara kushtetuese.
34. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues çmon se të dhënat e rezultuara nga hetimi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, bazuar në komunikimet e kryera në aplikacionin *SkyECC*, të poseduar dhe të përdorur nga shtetasi Xhevahir Lita, i datëlindjes 08.03.1973 (subjekti i rivlerësimit), të pakundërshtuara në ankim prej këtij të fundit dhe të pranuar nga Gjykata e Lartë si prova të përdorshme, referuar vendimit të kësaj Gjykate nr. 00-2023-2238 (364), datë 22.12.2023, vlerësohen të mjaftueshme për të vlerësuar në kuadër të këtij procesi rivlerësimi kalimtar, *sui generis* dhe me natyrë administrative (qartësisht jopenale), integritetin e figurës së magjistratit, në kuptim të parashikimeve të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, si dhe përshtatshmërinë e sjelljes së tij në raport me vlerat themelore¹³, standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së magjistratit¹⁴, nga i cili kërkohet një standard i lartë sjelljeje, gjatë ushtrimit të detyrës dhe jashtë saj, në kuadër të moscenimit të

¹³ Në nenin 3 të ligjit nr. 96/2016, “Vlerat themelore”, përcaktohet shprehimisht:

“1. Magjistrati ushtron funksionet e tij, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.

2. Magjistrati ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye.

3. Magjistrati nuk duhet të krijojë kontakte të papërshtatshme dhe nuk duhet të ndikohet nga pushteti ekzekutiv ose nga pushteti legjislativ. Magjistrati duhet të marrë çdo masë për të qenë dhe të duket se është jashtë çdo ndikimi prej tyre. Magjistrati njofton menjëherë Këshillin dhe kryetarin, në rast se evidenton ndërhyrje ose ushtrim të ndikimit të papërshtatshëm ndaj tij.

4. Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykime.

5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërbajtje dhe maturi”.

¹⁴ Shih nenin 4 të ligjit nr. 96/2016, “Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes”, në të cilën përcaktohet:

“1. Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare.

2. Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar: a) dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij; b) reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë; c) statusin e funksionit të magjistratit [...]”.

besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, si pasojë e dyshimeve të arsyeshme që mund të lindin në perceptimin e një vëzhguesi të jashtëm mbi integritetin e figurës së një magjistrati, kur ai përfshihet në komunikime si ato të evidentuara në vendimin e Komisionit, pavarësisht nëse provohet apo jo konsumimi i ndonjë vepre penale, në procese penale, aktuale apo në të ardhmen.

35. Rrjedhimisht, nga shqyrtimi i situatës faktike të konstatuar nga hetimi administrativ, si dhe analizimi i kuadrit kushtetues dhe ligjor si më sipër përmendur, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar në parashikimet e nenit Dh, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 3, pikat 6 e 15 dhe 38, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, gjetjen e Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ se subjekti i rivlerësimit duket të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kjo gjetje e hetimit administrativ, e vendosur në kuadrin kushtetues dhe ligjor në të cilin zhvillohet procesi i rivlerësimit kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve, ku barrën e provës për të provuar të kundërtën e sa konstatuar gjatë hetimit administrativ mbi ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, e kanë subjektet e rivlerësimit dhe, në rast dështimi, ndaj tyre zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në përputhje me parashikimin e nenit Dh, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duhet ta kishte drejtuar Komisionin drejt arritjes në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, në kuptim të parashikimeve të nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, shkarkimin e tij nga detyra duhet ta kishte bazuar në parashikimet e nenit 61, pika 2 e të njëjtit ligj, për sa kohë kishte arritur konkluzionin e drejtë të evidentuar edhe në vendimin objekt ankimi se: *subjekti ka pasur kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.*
36. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim se vendimmarrja e Komisionit, duke shkarkuar subjektin e rivlerësimit lidhur me fakte dhe rrethana të përfshira në një hetim penal, cenon parimin e prezumimit të pafajësisë, u çmuan nga trupi gjykues të pabazuara, për sa kohë Kushtetuta dhe Aneksi i saj në mënyrë të shprehur dhe të qartë ka bërë dallimin mes procesit të rivlerësimit kalimtar dhe një procesi penal, ku standardet e provueshmërisë së akuzës penale u nënshtrohen rregullave dhe parimeve të legjislacionit penal. Në këtë kuptim, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, jo vetëm ekzistenca e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar merret në analizë në drejtim të vlerësimit të integritetit të figurës së subjektit të rivlerësimit, pavarësisht nëse sjelljet dhe veprimet e tij në ndërveprim me këta persona përbëjnë apo jo vepër penale, por edhe konkluzionet e arritura në kuadër të këtij procesi nuk mund kurrsesi të diktojnë apo të ndikojnë në ecurinë e procedimit penal në ngarkim të subjektit të rivlerësimit.
37. Në përfundim të analizës së mësipërme lidhur me kriterin e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se Komisioni, në trajtimin e këtij kriteri, nuk ka kualifikuar drejt nga ana juridike situatën faktike të konstatuar në mënyrë të plotë dhe të saktë. Pavarësisht sa më sipër, i orientuar nga nevoja për të garantuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, duke mos e rënduar pozitën e tij, trupi gjykues çmoi se rikualifikimi ligjor i situatës faktike lidhur me vlerësimin e këtij kriteri, është i panevojshëm, për sa kohë që vendimi objekt kontrolli mbetet i pacenuar në drejtim të zgjidhjes së çështjes, meqenëse konkluzioni

përfundimtar i Komisionit – nga vlerësimi tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke e kualifikuar atë sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 – ka çuar në të njëjtën pasojë juridike, atë të dhënies së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit vlerësohet i drejtë dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 796, datë 04.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Xhevahir Lita.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 16.12.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi